

A përcakton Islami një sistem politik?¹

Dr. Fehed bin Saalih el-'Axhlaan

Më poshtë ke tri shprehje. Cili është dallimi mes tyre?

- a. Islami nuk përcakton sistemin politik dhe njerëzit zgjedhin sistemin më të mirë politik për vetët e tyre.
- b. Islami nuk përcakton sistemin politik, kështu që njerëzit zgjedhin sistemin më të mirë për çështjet e tyre të kësaj bote.
- c. Islami përcakton sistemin politik.

Është e qartë se çelësi i zgjidhjes së problemit në këtë pyetje është të kuptuarit se çfarë mendohet me një “sistem të caktuar politik” në secilën shprehje.

Përkufizimi i termave para nxjerrjes së gjykimit është një parakusht metodologjik. Jo rrallëherë anët teknike dhe termat e panjohur si ky luajnë një rol në përvetësimin e qëndrimeve që paraprakisht nuk mendohet të përvetësohen.

Nëse me “sistem politik” mendohet në mekanizma, instrumente e procedura të caktuara të administrimit, të cilat, fjala vjen, kanë të bëjnë me mënyrën se si një person merr pushtetin në mënyrë islamike; kush ka të drejtë të votojë për të e si, etj., atëherë sigurisht që Sheriati nuk rekomandon një sistem të caktuar politik, meqë këto procedura ndryshojnë sipas kohës dhe vendit. Më së miri është t’u lihet njerëzve të vendosin çfarë sistemi u përshtatet më shumë. *Shura’* (konsultimi) është e detyrueshme në Sheriat, kur kemi të bëjmë me përzgjedhjen e një pushtetari. Por, si ndodh kjo *Shura’*? *Shura’* nuk përkufizohet në një mënyrë të caktuar, sepse është një çështje dinamike. Njerëzit duhet të zgjedhin procedurat më të mira për vetët e tyre, ku kihet parasysh edhe dobia nga mënyrat moderne, të zbatuara nga organizata bashkëkohore në caktimin e autoritetit, siç janë zgjedhjet (votimet) moderne.

Nëse me “sistem politik” mendohet në tërësinë e rregullave dhe ligjvënive, atëherë kjo përcaktohet kategorikisht (në Islam), meqë ka rregulla, ligje, dhe ligjvënie të gërshetuara me çështje politike. Sistemi politik islamik ka të bëjë me ligje e ligjvënie në fusha që kanë të bëjnë me bazat e tij, si: drejtësia, mëshira, e mira e përgjithshme, konsultimi, etj.; ose në fusha që kanë të bëjnë me rregulla të caktuara, si: parandalimi i të ndaluarës (haramit), kushtet që kanë të bëjnë me autoritetin shtetëror, dhe gjëra të tjera.

Prej këtu, nëse me “sistem politik” mendohet në procedura, mënyra, mjete e operime, atëherë kjo gjë nuk specifikohet në Sheriat. Për shembull, alkooli duhet të ndalohet, mirëpo procedurat e ndërmarra për të detyruar këtë ndalim,

¹ Shënim i përkthyesit nga arabishtja në anglisht: Artikulli original në arabisht titullohet *Hel Xha'a l-Islam bi Nizaam Sijasi Muhadded*, që mund të shikohet këtu: <http://www.saaid.net/Doat/alajlan/81.htm>

përgjegjësitë për këtë dhe atë se si duhet trajtuar krimin, të gjitha janë çështje procedurash të detajuara, që janë të hapura për ndërhyrje nga sistemi. Megjithatë, nëse bëhet fjalë për rregulla dhe ligjvënien, atëherë disa seksione dhe ligjvënien janë të përcaktuara dhe të qarta.

Atëherë, shprehja e tretë e përmendur në fillim, është e gabuar, sepse parashtron që Islami ka një sistem të caktuar politik. Kjo, deri diku, është edhe përgjithësuese, prandaj dhe duhet sqaruar qëllimin e shprehjes. Nëse shprehja mbetet e paqartë, kjo do të krijojë të çdonjëri përshtypjen se Sheriati ka një procedurë specifike të përcaktuar për qarkullimin e autoritetit, si p.sh. për procesin e zgjedhjes së një udhëheqësi. Pra, këtu s'ka saktësim.

Për sa i përket shprehjes së dytë dhe të tretë, segmenti përmbyllës i secilës shprehje sqaron qëllimin mbrapa "sistemit të caktuar politik". Shprehja e dytë sugjeron që njerëzit duhen të nxjerrin ligje për çështjet e kësaj bote me atë që e shohin si më të mirë. Domethënia e "çështjeve të kësaj bote" këtu vlen për qeverisjen e njerëzve dhe kjo sugjeron që Sheriati s'ka të bëjë asgjë me këtë fushë a me këtë temë. Ky është të menduarit ideologjik sekularist se feja s'ka kurrfarë roli në çështjet e përgjithshme shoqërore ose në sferën e çështjeve të kësaj bote dhe njerëzit duhet të vendosin vetë se çfarë është më mirë për ta.

Shprehja e dytë mund të çorientojë lexuesin. Kjo e përparon më tej shprehjen "sistem i caktuar politik" në mënyrën që do të mund të nënkuptonte një qëndrim të saktë, ndonëse qëllimi i saj është që vetëm të shërbejë si një platformë për një qëndrim të gabuar, pra që çështjet e kësaj bote rregullohen sipas asaj që shihet si më e dobishme dhe të mos ketë vend për ligje e rregullore islamike. S'do mend se kjo është e pavërtetë, sepse Sheriati, për sa u përket muslimanëve, nuk është si cilado fe tjetër ashtu siç konceptohet nga sekularistët të cilët e konsiderojnë fenë si diçka të kufizuar në marrëdhënie personale mes robit dhe Krijuesit. Përkundrazi, Sheriati është një mënyrë jete. Ka rregulla të Sheriatit lidhur me ekonominë, siç është ndalimi i kamatës (*riba*), ashtu siç ka rregulla lidhur me politikën, siç është ndalimi që një jobesimtar të bëhet president vendi, si dhe rregulla për qeverisjen e sferës publike, siç është ndalimi i paturpësisë dhe i pararendësve të saj dhe të tjera rregulla të cilat janë menduar të rregullojnë çështjet e kësaj bote.

Atëherë, shprehja e saktë është e para, e cila përshkruan "sistemin e caktuar politik" si një që ndërlidhet me sistemin administrativ. Pra, njerëzit mund të zgjedhin të përdorin çfarëdo sistemi që duan, meqë s'ka rregullore të veçantë për këtë. Mirëpo, kur një sistem i këtillë të vihet në funksion, duhet patjetër të zbatohet sheriatin islamik. Kjo e bën të dallojë nga shprehja e dytë, e cila anulon krejtësisht rregullat e Sheriatit nga jeta sekulare.

Sigurisht, një person mund të thotë këso shprehje dhe të ketë si qëllim një kuptim të pranueshëm. Dhe kjo është e tolerueshme. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet dhe të kihet kujdes për faktin se disa njerëz qëllimisht zgjedhin shprehje të këtilla të paqarta. Shprehja e dytë mund të gjendet me

bollëk në literaturën sekulariste. Ata përdorin këso shprehje qëllimisht. Ti mund të lexosh këso shprehje pa e dalluar mirë qëllimin në përdorimin e saj. Në vend që ai (sekularisti) të thotë se Sheriati s'ka të bëjë me ligjvënien dhe sistemin e përgjithshëm (të qeverisjes) ose të përdorë shprehje për të cilat ai e di se do t'ua lëndojnë ndjenjat njerëzve, ai zgjedh fjalë më të buta dhe më të lehta për t'u pranuar, ndonëse synohet qëllimi i njëjtë (mënjanimi i Sheriatit).